

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Keshilli i Ministrave

VENDIM
Nr. 269, date 28.4.2005

PER KRITERET DHE MASEN E MBULIMIT FINANCIAR TE KUJDESIT
SHENDETESOR PER USHTARAKUN E FORCAVE TE ARMATOSURA

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te nenit 40, te ligjit nr.9210, date 23.3.2004, "Per statusin e ushtarakut te Forcave te Armatosura te Republikes se Shqiperise", me propozimin e ministrit te Mbrojtjes, Keshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ushtaraku aktiv i Forcave te Armatosura dhe pjesetaret e familjes ne ngarkim te tij, si dhe ushtari i sherbimit te detyrueshem aktiv, qe diagnostikohen apo kurohen ne institucionet shendetesore, ushtarake apo civile, publike, brenda vendit, perfitojne kujdes shendetesor pa pagese, vetem ne perputhje me sistemin e referimit, te percaktuar nga Ministria e Shendetesise.

Shpenzimet per sherbimet e kujdesit shendetesor, qe, per arsye objektive, nuk ofrohen nga institucione shendetesore publike, ne haze te vendimit te Komisionit Mjekesor te Spitalit Ushtarak Qendror Universitar, per qe mood te behen ne institucione shendetesore, private, brenda vendit, te mbulohen nga buxheti i Ministrise se Mbrojtjes, i parashikuar per kete qellim.

2. Kur vendoset qe diagnostikimi apo kurimi te kryhet ne institucione shendetesore jashte vendit, ne baze te vendimit te Komisionit Mjekesor te Spitalit Ushtarak Qendror Universitar, shpenzimet per diagnostikimin apo kurimin e ushtarakut te Forcave te Armatosura dhe te ushtarit te sherbimit te detyrueshem aktiv, mbulohen ne masen 100 per qind nga buxheti i Ministrise se Mbrojtjes, ndersa shpenzimet per pjesetaret e familjes ne ngarkim te ushtarakut aktiv te Forcave te Armatosura mbulohen ne masen 50 per qind dhe diferenca perballohet nga vete perfituesi.

Shpenzimet e udhetimit per ushtarakun aktiv te Forcave te Armatosura te perballohen ne masen 80 per qind nga buxheti i Ministrise se Mbrojtjes dhe per pjesetaret e familjes se tij 50 per qind, ndersa shpenzimet e udhetimit per ushtarin e sherbimit te detyrueshem aktiv, te perballohen ne masen 100 per qind nga buxheti i Ministrise se Mbrojtjes.

3. Ushtaraku ne rezerve, lirim apo pension, i Forcave te Armatosura dhe pjesetaret e familjes ne ngarkim te tij, si dhe ushtari i sherbimit ne rezerve kur semuret ne sherbimin ushtarak, kur diagnostikohen apo kurohen ne institucionet shendetesore ushtarake apo civile, publike, perfitojne kujdes shendetesor pa pagese, ne perputhje me sistemin e referimit te percaktuar nga Ministria e Shendetesise.

Kur sherbimet e kujdesit shendetesor, sipas kesaj pike, per arsye objektive, nuk ofrohen nga institucionet shendetesore publike, ne baze te vendimit te Komisionit Mjekesor te Spitalit Ushtarak Qendror Universitar, ato mund te behen ne institucione shendetesore private, brenda vendit. Ne kete rast, shpenzimet per keto sherbime mbulohen nga buxheti i Ministrise se

Mbrojtjes, i parashikuar per kete qellim.

4. Kur, per ushtarakun ne rezerve, lirim apo pension, te Forcave te Armatosura ne baze te vendimit te Komisionit Mjekesor te Spitalit Ushtarak Qendror Universitar, vendoset qe diagnostikimi apo kurimi te kryhen ne institucionet shendetesore jashte vendit, shpenzimet te perballohen ne masen 50 per qind nga buxheti i Ministrise se Mbrojtjes, ndersa per pjesetaret e familjes ne ngarkim te tij te perballohen ne masen 30 per qind nga buxheti i Ministrise se Mbrojtjes. Pjesa e mbetur te perballohet nga vete perfituesi.

Kur ushtari i sherbimit ne rezerve semuret gjate sherbimit ushtarak, dhe ne baze te vendimit te Komisionit Mjekesor te Spitalit Ushtarak Qendror Universitar, vendoset te dergohet per diagnostikim apo kurim ne institucionet shendetesore jashte vendit, shpenzimet mbulohen ne masen 100 per qind nga buxheti i Ministrise se Mbrojtjes, i parashikuar per kete qellim.

Kur ushtaraku ne rezerve, lirim apo pension, i Forcave te Armatosura dhe ushtari i sherbimit ne rezerve, dergohen per diagnostikim apo kurim ne institucionet shendetesore jashte vendit, shpenzimet e udhetimit mbulohen ne masen 50 per qind nga buxheti i Ministrise se Mbrojtjes dhe 50 per qind nga ata vete.

Kur pjesetaret e familjes ne ngarkim te ushtarakut ne rezerve, ne lirim apo pension, dergohen per diagnostikim apo kurim ne institucione shendetesore jashte vendit, shpenzimet e udhetimit mbulohen ne masen 30 per qind nga buxheti i Ministrise se Mbrojtjes.

5. Te drejtat e parashikuara ne pikat 1, 2, 3 dhe 4, te ketij vendimi, gezohen vetem kur kohezgjatja e sherbimit ushtarak eshte jo me pak se 1 vii, me perjashtim te ushtarit te sherbimit te detyrueshem aktiv.

6. Ministria e Mbrojtjes, per ofrimin e sherbimeve te siperpermendura, u drejtohet qendrave mjekesore te shteteve me te cilat ka nenshkruar marreveshje per kete qellim.

7. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes per zbatimin e ketij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne "Fletoren zyrtare" dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.11.2005.

KRYEMINISTRI
FATOS NANO
Ne mungese dhe me porosi
ZEVENDESKRYEMINISTRI
NAMIK DOKLE

MINISTRI I MBROJTJES
PANDELI MAJKO